



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/ Kosovo Prosecutorial Council

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 4 paragrafi 1.8 të Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 83 publikuar me datë 29 tetor 2010) dhe nenit 2 paragrafi 1.29 të Ligji Nr. 05/L-035 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 17 publikuar me 30 qershor 2015, në takimin e mbajtur me datë 14 tetor 2016, miraton këtë:

RREGULLORE NR. 08 / 2016

PËR EMËRIMIN E KRYEPROKURORËVE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Kjo Rregullore ka për qëllim të përcaktojë procedurën e emërimit të Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit dhe kryeprokurorëve të prokurorive themelore të Kosovës.
2. Kjo Rregullore përcakton edhe procedurën për caktimin e zëvendës kryeprokurorëve, udhëheqësve të departamenteve dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të kryeprokurorëve.

Neni 2

Parimet e përgjithshme

1. Procesi i emërimit të kryeprokurorëve të prokurorive përkatëse duhet të jetë i hapur, transparent, në përputhje me parimet e konkurrencës, objektivitetit, paanshmërisë, barazisë gjinore dhe shumëetnicitetit.
2. Anëtarët prokurorë të KPK duhet të japin dorëheqje nga KPK para aplikimit për pozitë të Kryeprokurorit.

Neni 3

Përkufizimet

Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:

"KPK"Këshilli Prokurorial i Kosovës;

"ZKPSH"Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit;
"LKPK"Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës;
"KPSH"Kryeprokurori i Shtetit;
"PSRK"Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës;
"PA"Prokurorinë e Apelit;
"PTH"Prokurorinë Themelore;
"KVPP"Komisioni për vlerësimin e përfomancës së prokuroreve;
"ZPD"Zyra e Prokurorit Disiplinor;
"Komisioni"Komisionin Vlerësues;
"Sekretariati"Sekretariati i KPK.

Neni 4

Kriteret e përgjithshme për emërimin e kryeprokuroreve

1. Kandidati për Kryeprokuror duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si në vijim:
 - 1.1. Të jetë prokuror me mandat të përhershëm;
 - 1.2. Të mos ketë të ngritur aktakuzë apo të mos jetë i dënuar për vepër penale, me përjashtim të kundërvajtjes;
 - 1.3. Të ketë vlerësim pozitiv të përfomancës;
 - 1.4. Të ketë reputacion të lartë profesional, personal dhe integritet moral.

Neni 5

Kriteret e veçanta për emërimin e kryeprokuroreve

1. Kandidati për Kryeprokuror duhet të plotësojë kriteret si në vijim:
 - 1.1. Për tu emëruar Kryeprokuror të PSRK-së kandidati duhet të jetë prokuror në PSRK.
 - 1.2. Për tu emëruar Kryeprokuror në Prokurorinë e Apelit kandidati duhet të ketë së paku pesë (5) vite përvojë si prokuror, nga të cilat tre (3) vite si prokuror në Departamentin për të Mitur ose në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore ose në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës.
 - 1.3. Për tu emëruar Kryeprokuror në Prokurorinë Themelore kandidati duhet të plotësojë kriteret për emërim në Departamentin për të Mitur apo Departamentin për Krime të Rënda të prokurorisë themelore.

Neni 6
Shpallja e konkursit për kryeprokurorë

1. KPK shpall konkurs për emërimin e kryeprokurorëve në të gjitha nivelet e prokurorive së paku 45 ditë para skadimit të mandatit të kryeprokurorëve të prokurorive përkatëse.
2. Në rastet kur pozita e kryeprokurorit mbetet e lirë para skadimit të mandatit të rregullt, konkursi do të hapet sa më parë që është e mundur.
3. KPK merr vendim për shpalljen e konkursit. Konkursi përmban kriteret për emërimin e kryeprokurorëve të prokurorive përkatëse dhe udhëzimin për aplikim për kryeprokurorë.
4. Vendimi dhe shpallja e konkursit publikohet në faqen e zyrtare të KPK-së dhe PSH në dy gjuhët zyrtare (Shqipe dhe Serbe) dhe fizikisht në të gjitha ndërtesat ku janë të vendosura prokuroritë përkatëse.
5. Konkursi do të jetë i hapur për pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e shpalljes.
6. Nëse për ndonjërin nga prokuroritë nuk pranohen asnjë aplikacion, KPK do të përsërisë konkursin vetëm për atë prokurori.

Neni 7
Aplikacioni

1. Kandidatët e interesuar për kryeprokuror, duhet të plotësojnë aplikacionin e publikuar në faqen zyrtare të KPK-së dhe PSH-së. Aplikacioni do të jetë pjesë integrale e kësaj Rregullore.
 - 1.1. Kandidatët përveç aplikacionit do të dorëzojnë edhe:
 - 1.1.1. Jetëshkrim (CV);
 - 1.1.2. Koncept dokument për menaxhimin e prokurorisë. Forma e Koncept dokumentit do të jetë pjesë integrale e kësaj rregullore.
 - 1.1.3. Çfarëdo dokumenti tjetër për të dokumentuar përvojën e tyre.

Neni 8
Komisioni Vlerësues

1. KPK pas mbylljes së konkursit, themelon Komisionin për vlerësim e kandidatëve për kryeprokurorë.
2. Komisioni përbëhet nga tre (3) anëtarë.

Neni 9
Dosja e kandidatit

1. Sekretariati i KPK bënë mbështetjen administrative të procesit për emërim të kryeprokurorëve.
2. Sekretariati i KPK do të përgatisë dosjet për secilin kandidat me të dhënat si në vijim:
 - 2.1. Dokumentet e dorëzuara nga kandidati të kërkuara sipas konkursit;
 - 2.2. Vlerësimin e performancës nga ana e eprorit për kandidatin për tre (3) vitet e fundit;
 - 2.3. Të dhënat nga KVPP për performancën e kandidatit. Nëse një vlerësim i tillë mungon, atëherë KVPP do ta bëjë vlerësimin e atij kandidati.
 - 2.4. Të dhënat për masat disiplinore të shqiptuara nga Komisioni Disiplinor i KPK-së;
 - 2.5. Informacione tjera nga burimet relevante.

Neni 10
Procesi i shqyrtimit fillestar

1. Komisioni fillimisht do të vlerësojë nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e caktuara me ligj.
2. Komisioni përpilon listën e kandidatëve të cilët i plotësojnë kriteret e kërkuara për emërim si kryeprokuror dhe do të njoftojë me shkrim kandidatët të cilët dështojnë në plotësimin e kriterëve bazë të përcaktuara me Ligj.

Neni 11
Intervistimi dhe poentimi i kandidatëve

1. Të gjithë kandidatët që i plotësojnë kriteret do të intervistohen. Të gjithë anëtarët e Komisionit duhet të jenë të pranishëm gjatë intervistimit.
2. Komisioni do të hartojë pyetjet për intervistë. Pyetjet duhet të përqendrohen në çështjet e përfshira në Koncept dokument, aftësitë menaxheriale të kandidatit dhe çfarëdo pyetje që ndërlidhet me integritetin e kandidatit.
3. Bazuar në shqyrtimin e materialeve të siguruara nga Sekretariati, kandidati dhe intervista, Komisioni do ta bëjë poentimin e kandidatëve sipas kategorive si në vijim:
 - 3.1. Integriteti personal, profesional dhe moral1 deri 20 pikë

- 3.2. Shkathhtësitë menaxheriale, administrative dhe organizative....1 deri 10 pikë
 - 3.3. Performanca e kandidatit.....1 deri 10 pikë
 - 3.4. Koncept dokumenti.....1 deri 10 pikë
4. Komisioni pas përfundimit të procesit të intervistimit të kandidatëve diskuton rreth votimit dhe përgatit listën përfundimtare të kandidatëve.
 5. Rezultati përfundimtar i poentimit për një kandidat do të përlllogaritet duke mbledhur pikët e dhëna një kandidat nga secili anëtar i Komisionit dhe më pas duke e përpjestuar me numrin e anëtarëve të Komisionit.

Neni 12

Rekomandimi i Komisionit

1. Komisioni përgatit një tabelë me vlerësimet e përgjithshme për secilin kandidat. Vlerësimi do të përmbajë:
 - 1.1. Poentimin e përgjithshëm për kandidatin.
 - 1.2. Arsyetimin për poentimin e përgjithshëm për kandidatin.
2. Komisioni do të përgatit edhe propozimin për KPK për listimin sipas secilës zyrë e cila do të përmbajë:
 - 2.1. Poentimin e përgjithshëm për secilin kandidat sipas rangimit të tyre.
 - 2.2. Poentimin e kandidatëve për secilën kategori të vlerësuar nga Komisioni.
 - 2.3. Aryestimin për poentimin e përgjithshëm për secilin kandidat.
 - 2.4. Secili kandidat do të pranojë një kopje të vlerësimit të tyre të përgjithshëm nga paragrafi 1 i këtij neni dhe do të kenë të drejtë të paraqitjes së kundërshtimit për shkak të shkeljeve ligjore apo gabimeve teknike në KPK brenda pesë (5) ditësh nga pranimi i vlerësimit.
3. Nëse dy kandidatët e parë kanë pikë të barabarta dhe janë të gjinive të ndryshme, Komisioni propozon kandidatin femër si të parën për tu votuar në Këshill.

Neni 13

Emërimi i kryeprokurorëve nga KPK

1. KPK do të shqyrtojë propozimin e Komisionit dhe çdo kundërshtim të paraqitur nga kandidatët. Këshilli do të vendos për kundërshtimet para votimit përfundimtar për secilën pozitë.
2. Nëse KPK gjen se një nga kundërshtimet është i bazuar, merr vendim që, Komisioni brenda aftatit prej pesë (5) ditësh të shqyrtojë përsëri vlerësimet dhe

t'i rekomandoj listë me kandidatët e propozuar. Vendimi i KPK për aprovimin e kundërshtimit duhet të jetë i arsyetuar.

3. Anëtarët e Komisionit nuk mund të jenë të pranishëm gjatë votimit të Këshillit, por mund të jenë të pranishëm para procedimit për të prezantuar të gjeturat e Komisionit dhe për tu përgjigjur cilësdorë pyetje të KPK.
4. Anëtarët e KPK do të kenë çasje në të gjitha materialet në dispozicion të Komisionit për secilin kandidat.
5. Anëtarët e KPK kanë të drejtë të ftojnë cilindo kandidat për tu paraqitur para KPK për tu përgjigjur pyetjeve specifike.
6. Këshilli voton për secilën prokurori veçmas dhe përmes votimit të fshehtë, ashtu siç parashihet në nenin 23 paragrafi 2 të Rregullores Nr.10/2015 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Prokurorial të Kosovës.
7. Nëse kandidati i parë nuk merr shumicën e votave pas votimit, atëherë Këshilli voton për kandidatin e dytë të propozuar në të njëjtën procedurë votimi si për kandidatin e parë. Nëse kandidati i dytë nuk merr shumicën e votave të Këshillit, konkursi do të rihapet.
8. Këshilli nuk është i obliguar të aprovojë përzgjedhjen e kryeprokurorit nëse është vetëm një kandidat për pozitën e caktuar.

Neni 14

Caktimi i zëvendës kryeprokurorëve dhe udhëheqësve të departamenteve

1. Kryeprokurori i prokurorisë përkatëse cakton zëvendësin e tij nga radhët e prokurorëve të asaj prokurorie, i cili në mungesë të kryeprokurorit e zëvendëson atë.
2. Në rast të pushimit të mandatit të kryeprokurorit, zëvendës kryeprokurori e ushtron detyrën e kryeprokurorit, por jo më gjatë se tre (3) muaj. Vendimin për caktimin e ushtruesit të detyrës e merrë KPK.
3. KPK me propozim të Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore të Prishtinës, cakton udhëheqësit e Departamentit të Përgjithshëm, Departamentit për të Mitur dhe Departamentit për Krime të Rënda në këtë prokurori.
4. Me propozim të kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse, KPK mund të caktojë udhëheqësit e departamenteve edhe për prokuroritë tjera.

Neni 15

Përfundimi i mandatit të kryeprokurorit

1. Mandati i kryeprokurorit para skadimit të rregullt përfundon bazuar në nenin 20.6 të Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenin 9 të

Ligjit Nr. 05/L-034 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, për shkaqet si në vijim:

- 1.1. dorëheqje;
 - 1.2. shkarkim;
 - 1.3. vdekje;
 - 1.4. arritjen e moshës së pensionimit;
 - 1.5. humbjen e aftësive të punës për shkaqe mjekësore të vërtetuara.
2. Përveç sipas paragrafit 1 të këtij neni, mandati i kryeprokurorit mund të përfundojë para kohe edhe për shkaqet në vijim:
- 2.1. Kur dënohet për vepër penale, me përjashtim të kundërvajtjes siç përkufizohet me ligj;
 - 2.2. Kur dështon në përmbushjen e detyrave të përcaktuara me ligj;
 - 2.3. Kur vlerësimi i përfomancës nga ana e KVPP është negativ;
 - 2.4. Kur nuk i zbaton udhëzimet dhe vendimet e përgjithshme të Kryeprokurorit të Shtetit dhe KPK, dhe
 - 2.5. Për shkak të keqmenaxhimit.
3. Kryeprokurori pas përfundimit të mandatit si kryeprokuror, do të rikthehet në pozitën e mëparshëm si prokuror.

Neni 16

Procedura për përfundimin e parakohshëm të mandatit të kryeprokurorit

1. KPK shkarkon kryeprokurorin përkatës nëse plotësohen ndonjë nga kushtet e përcaktuara në nenin 15 të kësaj Rregullore.
2. Kryeprokurori i Shtetit mund t'ia propozoj KPK shkarkimin e kryeprokurorit përkatës sipas kushteve të përcaktuara me nenin 15. Propozimi paraqitet në formë të shkruar me arsyetim përkatës.
3. Kryeprokurori për të cilin është paraqitur propozimi për shkarkim mund të ftohet për tu deklaruar para KPK-së.
4. Vendimin për shkarkimin e kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse e merr KPK me shumicën e votave.

Neni 17
Dispozitat përfundimtare

1. Kjo Rregullore në përbërjen e saj ka shtojcat në vijim:
 - 1.1. Formularin për aplikim për pozitën e kryeprokurorit, dhe
 - 1.2. Formularin e Koncept dokumentit të kandidatit për kryeprokuror.

Neni 18
Hyrja në fuqi

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, shfuqizohet Rregullorja 03/2015 për Emërimin e Kryeprokurorëve.
2. Kjo Rregullore hynë në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Prishtinë më, 14 tetor 2016

Blerim Isufaj

Kryesues
Këshilli Prokurorial i Kosovës



Shtojca 1

FORMULARI PËR APLIKIM PËR POZITËN E KRYPROKURORIT

Nr. i regjistrimit	Data

1. Të dhënat personale				
Emri		Mbiemri		[] Mashkull [] Femër
Adresa e tanishme:				
2. Informata lidhur me familjarë				
2.1 A është ndonjë nga të afërmit tuaj anëtar i KPK-së? PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>				
2.2 A është ndonjë nga të afërmit tuaj i punësuar në KPK apo në Prokurorin e Shtetit? PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>				
Nëse përgjigja ndaj ndonjëres nga pyetjet më lartë është "Po", atëherë jepni të dhënat si në vijim:				
Emri	Marrëdhënia	Institucioni dhe pozita		
3. Antarësia në parti politike				
Deklaroj se nuk jam pjesëtar i ndonjë partie politike.				
Nënshkrimi: _____ Data: _____				
1. Ankesat ndaj jush				
Kjo pjesë ka tetë pyetje. Përgjigjuni në secilën pyetje me "PO" ose "JO". Për çdo përgjigje "PO" ofroni informacionin e kërkuar.				
4.1 A është paraqitur ndonjëherë ankesë ndaj jush në ndonjë organ disiplinor? PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>				
Data e ankesës				
Paraqitur në		Emri i ankuesit		
Përshkruaj:				
A keni qenë të informuar lidhur me paraqitjen e ankesës? PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>				
Data e njoftimit:		Njoftimi është bërë nga:		
4.2 A është zhvilluar ndonjëherë procedurë hetimore ndaj jush si rezultat i ndonjë ankese?				
PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>				

Data e nisjes së hetimit			
Hetimi u zhvillua nga (institucioni)			
Qyteti		Shteti	
A keni qenë i njoftuar lidhur me nisjen e hetimeve? PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>			
Data e njoftimit:		Njoftimi është bërë nga:	
4.3 Si rezultat i këtij hetimi, a është rekomanduar ndonjë masë sanksionuese (p.sh. vërejtje, gjobe, punë provuese, pushim i detyrueshëm, rehabilitim, shkarkim, ulje në pozitë apo ndonjë masë tjetër sanksionuese)? PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>			
Data e rekomandimit			
Autoriteti rekomandues			
Përmbajtja e rekomandimit			
Qyteti		Shteti	
A keni qenë të informuar lidhur me rekomandimin. PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>			
Data e njoftimit:		Njoftimi është bërë nga:	
4.4 Përshkruani hapat e ndërmarrë nga ana e organit përkatës në lidhje me rekomandimin:			
4.5 A ju është shqiptuar ndonjëherë masa e sanksionimit si p.sh vërejtje, gjobë, punë provuese, pushim i detyrueshëm, rehabilitim, shkarkim ose ulje në pozitë apo ndonjë lloj tjetër i sanksionimit si rezultat i rekomandimit? PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>			
Masa sanksionuese			
Shqiptuar nga		Data e sanksionimit	
A keni qenë të informuar lidhur me masën sanksionuese? PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>			
Data e njoftimit:		Njoftimi është bërë nga:	
4.6 A është zbatuar masa disiplinore? PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>			
Data e fillimit të zbatimit të masës sanksionuese:			
Data e përfundimit të zbatimit të			

masës disiplinore:			
4.7 A ju është shqiptuar ndonjëherë masa për suspendim të përkohshëm? PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>			
Kërkesa për suspendim ishte bërë nga:			
Autoriteti i ngarkuar me imponimin e masës së suspendimit		Data e vendimit	
Kohëzgjatja e suspendimit			
4.8 Jepni informata shtesë që ndërlidhën me pjesën nr. 4 të këtij formulari, për të cilat ju mendoni se janë të rëndësishme për tu adresuar gjatë procesit të shqyrtimit të aplikacionit tuaj			

5. Shkeljet penale			
Kjo pjesë ka njëmbëdhjetë pyetje. Përgjigjuni në çdo pyetje me "PO" ose "JO". Për çdo përgjigje "PO" ju lutemi jepni informatat e kërkuara.			
5.1.A jeni hetuar ndonjëherë për ndonjë vepër penale? PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>			
Data kur kanë nisur hetimet		Data kur kanë përfunduar hetimet	
Hetimet u zhvilluan nga (institucioni)			
Qyteti ku ishin zhvilluar hetimet		Shteti	
Lloji i veprës penale:			
5.2.A keni qenë ndonjëherë i arrestuar apo i dyshuar për aktivitet kriminal? PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>			
Data e arrestimit		Qyteti	
		Shteti	

I arrestuar nga (institucioni)			
Arsyeja e arrestimit:			
5.3.A keni qenë i akuzuar ndonjëherë për vepër penale? PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>			
Data e ushtrimit të aktakuzës			
Vendi i ushtrimit të aktakuzës		Shteti	
I akuzuar për			
Përshkruani rastin shkurtimisht:			
5.4.A jeni gjykuar ndonjëherë për vepër penale? PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>			
Data e dënimit		Gjykata	
Qyteti		Shteti	
I dënuar për			
Natyra e vendimit të gjykatës (përshkruani vendimin):			
5.5. Nëse kundër vendimit të shkallës së parë është ushtruar ankesë me mjete të rregullta juridike, ju lutemi plotësoni informacionin e kërkuar në vijim.			
Data e vendimit të shkallës së dytë		Gjykata e shkallës së dytë	
Qyteti		Shteti	
5.6 Nëse vendimi është kundërshtuar me anë të mjeteve të rregullta juridike, ju lutemi jepni të gjitha detajet?			

5.7 Nëse është shqiptuar ndonjë masë sanksionuese nga gjykata, a është zbatuar ajo? PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>				
Gjykata që bëri zbatimin		Qyteti		Shteti
5.8 A keni marrë pjesë ndonjëherë në cilësinë e paditësit apo të paditurit në gjykatë civile apo ekonomike (duke përjashtuar rastet e shkurorëzimit)? PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>				
Data e procesit gjyqësor		Gjykata		
Gjykata ku është ushtruar procedura gjyqësore			Shteti	
Përshkrimi i procesit gjyqësor:				
5.9 Nëse kundër vendimit është ushtruar ankesë me mjetë të rregullta ose të jashtëzakonshme juridike, ju lutemi jepni të gjitha detajet?				
5.10 A keni vepruar ndonjëherë në cilësinë e debitorit në ndonjë procedurë apo të kreditorit në procedurë të ekzekutimit? PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>				
Data kur është ushtruar padia për ekzekutim				
Qyteti		Shteti		
Gjykata				
Përshkrimi i padisë:				

6 GJUHA PËR INTERVISTË	
Dëshiroj të intervistohem në:	
<input type="checkbox"/> Gjuhën Shqipe	<input type="checkbox"/> Gjuhën Serbe

7 AUTORIZIMI PËR KËRKIMIN DHE DHËNIEN E INFORMATAVE PERSONALE	
Me anë të nënshkrimit tim:	
- Unë e autorizoj KPK-ën që të marrë informata për mua nga organet e shënuara më poshtë;	
- Unë i autorizoj organet e shënuara më poshtë që t'i ofrojnë KPK-së informatat e mia personale;	
- Policia e Kosovës, Gjykatat e Kosovës dhe organet përkatëse në shtetet tjera që mbajnë shënime të hetimeve penale dhe dënimeve;	
- Zyra e Prokurorit Disiplinor;	
- Agjencia kundër Korrupsionit.	
Data:	Nënshkrimi: _____

Deklarimi dhe konfirmimi	
Me anë të nënshkrimit tim, unë deklaroj se:	
<ul style="list-style-type: none"> • Informatat në këtë formular aplikimi dhe informatat e përfshira në shtojcat e këtij formulari për emërim si prokuror janë të vërteta dhe të sakta, dhe janë bërë nën përgjegjësinë për deklaram të rrejshëm; • E autorizoj Këshillin Prokurorial të Kosovës për të verifikuar këto informata; • Jam i vetëdijshëm se për çdo deklaram të rrejshëm në këtë formular aplikimi unë do ta humb të drejtën e emërimit si Kryeprokuror; • Jam i vetëdijshëm se për çdo deklaram të rrejshëm në këtë formular aplikimi i cili do të zbulohet pas emërimit tim si Kryeprokuror i Prokurorisë, menjëherë mund të jem objekt i procedurës disiplinore dhe të rekomandohem për shkarkim nga pozita e Kryeprokurorit. 	
Data:	Nënshkrimi: _____

Shtojca 2: FORMULARI I KONCEPT DOKUMENTIT

Emri:	
Mbiemëri:	

- I. Përshkruani aftësinë tuaj për të planifikuar dhe organizuar punën brenda prokurorisë për të arritur rezultate pozitive.
- II. Përshkruani aftësinë tuaj në aspektin e planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit, planifikimit të punës, hartimin dhe pregaditjen e raporteve si kreu administrativ i prokurorisë në ushtrimin sa më efikas dhe efektiv të përgjegjësive tuaja prokuroriale.
- III. Përshkruani veprimet që do të ndërmermi për të krijuar dhe mbajtuar raporte pozitive me prokurorët e prokurorisë tuaj dhe stafin administrativ.
- IV. Përshkruani se si planifikoni të fokusoheni në përmirësimin e vazhdueshëm të performancës, transparencës dhe në zvoglimin e numrit të lëndëve.
- V. Sipas mendimit tuaj, cilat janë sfidat e sistemit prokurorial të Kosovës, në veçanti të zyrës në të cilën ju konkuroni dhe si mendoni t'i adresoni ato sfida?

Data: ___/___/2016

Nënshkrimi: _____